



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 4096/1 6/220 dt. 21 12 2023

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr.19 datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit të miratuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me datë 26.07.2023, si dhe bazuar në propozimin për miratimin e Planit të Integritetit të Koordinatorit të grupit punues i caktuar sipas vendimit Nr.020/04-57011 të datës 22.11.2023, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.020/04-57011 të datës 22.11.2023 .
2. znj Altina Mulaj Hajdini, Zyrtare ligjore-Zyra e Kryetarit caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit .
3. Me këtë vendim shfuqizohet edhe Plani aktual i Integritetit 01-030/01-64886 i datës 19.12.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 20.12.2023 titullari i institucionit nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr. 020/04-57011 të datës 22.11.2023, të theksuar si në pikën I të dispozitivit të Vendimit.

[Signature]

Znj. Altina Mulaj Hajdini sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Përmes këtij vendimi sipas pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi njëkohësisht shfuqizohet edhe Plani paraprak i Integritetit Nr.01-030/01-64886 i datës 19.12.2022 .

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitivin e këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Personit përgjegjës*
- *Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit*
- *Zyrës së Personelit;*
- *Arkivit të Komunës së Drenasit*